



REGJISTRIMI I FAKTIT TË VDEKJEVE NË KOSOVË

DHJETOR 2010



Ky raport është shkruar nga PRISM Research, Zyra në Prishtinë.
Falënderojmë të gjithë hulumtuesit që kanë qenë të përfshirë në realizimin e projektit dhe atyre që kanë pranuar të intervistohen për këtë projekt.

PËRMBAJTJA

<u>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</u>	<u>3</u>
1.1. QËLLIMI I HULUMTIMIT.....	3
1.2 OBJEKTIVAT	3
1.3. METODOLOGJIA	4
1.4. REZULTATET	4
<u>2. HYRJE</u>	<u>6</u>
2.1 REGJISTRIMI I VDEKJES: NJË VËSHTRIM STATISTIKOR	7
<u>3. HULUMTIMI I REGJISTRIMIT TË VDEKJES NË KOSOVË– PROFILI I TË ANKETUARVE</u>	<u>7</u>
3.1. SITUATA ME REGJISTRIMIN E VDEKJES NË KOSOVË	7
3.2. REGJISTRIMI DHE ÇERTIFIKATA E VDEKJES	8
3.2.1. CERTIFIKATA E VDEKJES DHE KOMUNITETET ETNIKE	8
3.2.2. CERTIFIKATA E VDEKJES NË VENDBANIMET URBANE DHE RURALE.....	9
3.3. SHKALLA E REGJISTRIMIT TË VDEKJES	10
3.4 KËRKESAT E REGJISTRIMIT TË VDEKJES.....	10
3.5. REGJISTIRMI ME KOHË DHE AI I VONSHËM.....	11
3.6. VENDI I REGJISTRIMIT TË FAKTIT TË VDEKJES.....	12
3.7. BURIMI I INFORMACIONIT MBI PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË VDEKJES.....	13
3.8. PËRVOJA ME PROCESIN E REGJISTRIMIT TË VDEKJES	14
3.9. PERCEPTIMI MBI PUNËN E KOMUNËS/CENDRAVE PËR REGJISTRIM TË GJENDJES CIVILE	15
3.10. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE PËRKATËSIA ETNIKE	16
3.11. SHTYTJA PËR REGJISTRIMIN E VDEKJES.....	16
3.12. INKURAJIMI I AUTORITETEVE PËR REGJISTRIMIN E VDEKJES.....	16
3.13. VETËDËJËSIMI / INFORMACIONET RRETH REGJISTRIMIT TË VDEKJES	18
<u>4. PËRFUNDIMET</u>	<u>18</u>
<u>SHTOJCA 1.....</u>	<u>20</u>
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	21

HULUMTIMI KUANTITATIV	21
HULUMTIMI KUALITATIV	26

Përmbledhja ekzekutive

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Regjistrimi i vdekjes është kërkesë ligjore. Në Kosovë kjo është e rregulluar me **Ligjin Nr. 2004/46 Për Regjistrat e Gjendjes Civile dhe Ligjin Nr. 02/L-126 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/46 Për Regjistrat e Gjendjes Civile**. Sipas këtij Ligji, “Regjistri i të vdekurve” është libri, në të cilin regjistrohen faktet e vdekjes së qytetarëve të territorit amë”.

Situata aktuale me regjistrimin e vdekjes në Kosovë, ashtu si në pjesën më të madhe të vendeve në zhvillim, është mjaft e dobët. Afro një e katërta deri në një e dyta e të gjitha vdekjeve nuk janë të regjistruara¹, (UNFPA, 2009). Kjo kërkon vëmendje. Për këtë qëllim, Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA) ka filluar një projekt hulumtimi për të fituar informacione mbi situatën e përgjithshme me regjistrimin e vdekjes në Kosovë. Qëllimi i këtij projekti të hulumtimit është që të përdoret ky informacion për të formësuar fushatën e ardhshme të vetëdijesimit mbi Regjistrimin e Vdekjes. Projekti është përqendruar në të kuptuarit e nivelit të vetëdijesimit, qëndrimet dhe praktikat e regjistrimit të vdekjes në pjesët urbane dhe rurale të Kosovës.

1.2 Objektivat

Objektivat e këtij studimi janë:

- Të mblidhen të dhëna themelore për të analizuar shkallën e regjistrimit të vdekjes në Kosovë
- Të mësohet për perceptimet mbi regjistrimin e vdekjes në Kosovë
- Të kuptohet niveli i informacioneve që kanë njerëzit në lidhje me procedurat e regjistrimit të vdekjes
- Të mësohen arsyet e regjistrimit apo mos-regjistrimit të rasteve të vdekjes
- Të kuptohet se sa janë të kënaqur njerëzit me punën e Zyrave të Regjistrimit të Gjendjes Civile
- Të përmbledhen informacionet e nevojshme dhe mjetet e informimit që nevojiten për fushatën e vetëdijesimit për regjistrimin e vdekjes.

¹ UNFPA, 2009, Vlerësimi i Sistemit të Regjistrimit Vital të Kosovës

Ky projekt i hulumtimit përqendrohet në regjistrimin e vdekjes në familjet të cilat kanë pas rast të vdekjes në tri vitet e fundit. Hulumtimi përqendrohet në çështjen e regjistrimit të vonshëm dhe gjithashtu eksploron çështjen e regjistrimit të vdekjes të foshnjave, nën 12 muaj. Për më tepër, projekti i hulumtimit tenton të vlerësojë procesin e regjistrimit të vdekjes, duke vlerësuar mundësinë e qasjes në shërbimet e regjistrimit në Komunitatet e Kosovës dhe duke kuptuar perceptimet e njerëzve, në mënyrë që të vërtetojë se ku qëndrojnë boshllëqet sistematike dhe se cilat do të ishin zgjidhjet më të mira.

1.3. Metodologjia²

Dy metoda janë përdorë për të analizuar çështjen e regjistrimit të vdekjes në Kosovë, në mes periudhës dhjetor 2007 dhe dhjetor 2010.

- **Hulumtimi kuantitativ përmes anketës** që përfshin një mostër prej 1,150 familjeve që kanë pas rast të vdekjes në tri vitet e fundit (dhjetor 2007- dhjetor 2010).
- **Hulumtimi kualitativ** që ka përfshi diskutimet në grupe të fokusuara që kanë ndihmuar në të kuptuarit më të thellë të çështjes në përgjithësi.

Këto dy metoda të analizës kanë ndriçuar faktorët kryesorë që ndikojnë në regjistrimin e vdekjes, duke përfshirë: faktorët politik, administrative dhe barrierat gjeografike, si dhe kërkesat ligjore.

1.4. Rezultatet

- Prej 1149 të anketuarve, 697 (apo 60.6%) prej tyre janë të regjistruar në Regjistrin e Vdekjes të Zyrës për Regjistrimin e Gjendjes Civile.
- 49% e të anketuarve jo-shqiptarë të cilët nuk e kanë regjistruar vdekjen e personit, janë nga komuniteti serb.
- Prej 753 vdekjeve që kanë ndodhur në shtëpi (65.4% e të gjitha vdekjeve të raportuara), 63% pohojnë se e kanë thirrur mjekun, apo personin përgjegjës për të konfirmuar/verifikuar vdekjen.
- Prej 18 të anketuarve të cilët kanë pas rast të vdekjes së foshnjave (12 muajsh e më pak), 15 prej tyre e kanë regjistruar lindjen e foshnjës, dhe 14 prej tyre pastaj (pas vdekjes) e kanë regjistruar foshnjën në regjistrin e vdekjes (prej të cilëve 8 janë

² Për më shumë hollësi rreth Metodologjisë, shihni Shtojcën I

meshkuj dhe 6 femra). Duket që gjinia nuk është ndonjë faktor i rëndësishëm në vendimin për regjistrimin e vdekjes së foshnjës.

- Sa i përket vendbanimi, pjesa më e madhe e të anketuarve nga pjesët rurale nuk e kanë regjistruar të ndjerin, krahasuar me të anketuarit në pjesët urbane.
- Gjithashtu, familjet me nivel mesatar, apo nën mesatar të të ardhurave, janë në mesin e atyre që nuk e kanë kryer regjistrimin e personit të vdekur.
- Tri arsyet kryesore për mos-regjistrim të theksuara nga të anketuarit janë 1) mos njohja e procedurave për marrjen e Certifikatës së Vdekjes (19%), 2) mungesa e dijenisë nëse është e nevojshme të merret Certifikata e Vdekjes (17%) 3) kostoja e lartë (14.5%).
- Nëpunësit në Zyrën e Gjendjes Civile / Departamenti për Regjistrim, duket se janë burimi kryesor i informacionit rreth regjistrimit të vdekjes (58.6%).
- Pjesa më e madhe e të anketuarve shqiptarë, boshnjak, turq dhe rom, pohojnë se e kanë kryer regjistrimin e vdekjes në institucionet e Kosovës.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve serb pohojnë se këtë e kanë bërë me autoritetet serbe të pas vitit 1999 që operojnë në Kosovë dhe 23.07% e kanë kryer këtë regjistrim me autoritetet (institucionet) serbe që operojnë në Serbi.
- Edhe pse nuk janë në dijeni për afatin e fundit të regjistrimit të faktit të vdekjes, pjesa më e madhe e të anketuarve që e kanë kryer regjistrimin, këtë e kanë bërë në më pak se një javë.
- Arsyeja më e përmendur për regjistrimin të vonshëm është se nuk kanë pas kohë, apo nuk e kanë ditur se duhet ta bëjnë këtë.
- Përvoja e gjithëmbarshme me procesin e regjistrimit të personit të vdekur, nga ana e atyre që e kanë bërë këtë, nuk konsiderohej as si e lehtë, po as e vështirë (37.5%).
- Rreth 43% kanë thënë që atyre iu është dashtë të vizitojnë Komunën/Zyrën për Regjistrimin e Gjendjes Civile, më shumë se një here, për të kryer procesin e regjistrimit.
- 44% janë në përgjithësi të kënaqur me punën e Zyrrave të Regjistrimit të Gjendjes Civile.
- Pjesa dërmuese e të anketuarve (89%) nuk kanë përjetuar ndonjë vonese apo vështirësi gjatë procesit të regjistrimit të vdekjes, për shkak të përkatësisë së tyre etnike.
- Tri arsyet kryesore që do të mund t'i bënin njerëzit që të regjistrojnë faktin e vdekjes së personit në familjen e tyre, janë:
 1. Thjeshtësimi i procedurave (32.52%)
 2. Shpërndarja e informacionit mbi regjistrimin e vdekjes (15.32%).

3. Të mundësohet asistenca (stimulimi) sociale për shpenzimet e varrimit, sidomos për pjesët më të cenuara të popullsisë (11.80%).
- Duket se nuk ka ndonjë inkurajim nga ana e autoriteteve, për regjistrimin e faktit të vdekjes.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se nuk do të duhet të ishte përgjegjësi e Qeverisë për të ngritur vetëdijen mbi regjistrimin e vdekjes.
- Kanali më i preferuar i informacionit për regjistrimin e vdekjes është televizioni (43%), përcjellë nga mediet e shtypura (36%).

2. HYRJE

Çdo vdekje duhet të regjistrohet në Regjistrin e Vdekjeve. Sipas Ligjit mbi Regjistrat e Gjendjes Civile, vdekjet duhet të regjistrohen në Zyrat e Regjistrimit të Gjendjes Civile brenda 30 ditësh, për vdekjet që kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës, përderisa për ato që kanë ndodhur jashtë territorit, afati për regjistrim është 60 ditë.

Vdekjet regjistrohen në Regjistrin e Vdekjes të Kuvendit Komunal ku ka ndodhur vdekja. Vdekjet që kanë ndodhur jashtë territorit të Kosovës regjistrohen në vendbanimin e fundit ku ka jetuar i ndjeri/e ndjera, në Kosovë. Ligji specifikon që fakti i vdekjes regjistrohet nga anëtarët e familjes së personit që ka vdekur, apo në rast se nuk ka të tillë, atëherë anëtarët e familjes më të gjerë, fqinjët apo dikush që është në dijeni për vdekjen e personit, mund të kryejë procesin e regjistrimit të vdekjes.

Gjatë regjistrimit, personit që bën kërkesë për regjistrimin e të ndjerit, duhet të paraqesë një certifikate nga institucioni shëndetësor, me të cilën konfirmohet vdekja e personit dhe në rast se nuk ka ndonjë certifikatë të tillë, atëherë regjistrimi bëhet me dy dëshmitarë (para gjykatës), të cilët kanë qenë të pranishëm në momentin e vdekjes apo gjatë varrimit.

Ligji gjithashtu specifikon që kur vdekja të ndodhë në shtëpi, anëtarët e familjes apo personat që janë të pranishëm, duhet ta thërrasin mjekun që të konfirmojë vdekjen e personit. Të gjitha rastet e vdekjes duhet të kenë konkluzionin se cili ka qenë shkaku i vdekjes së personit, që lëshohet nga instituti shëndetësor.

2.1 Regjistrimi i vdekjes: Një vështrim statistikor

Rreth një e katërta po gjysma e të gjitha vdekjeve nuk janë të regjistruara (UNFPA, 2009)³.

3. HULUMTIMI I REGJISTRIMIT TË VDEKJES NË KOSOVË– Profili i të anketuarve

Hulumtimi është realizuar në tërë territorin e Kosovës. Prej 1149 të anketuarve që kanë qenë të përfshirë në hulumtim, 65.6% jetojnë në pjesët urbane dhe 34.4% jetojnë në pjesët rurale të Kosovës. Një pjesë e madhe e të anketuarve (39.1%) kanë pas arsimim të mesëm, një pjesë e tyre, apo 22.2% kanë kryer 5-8 vjet të arsimit fillor, disa kanë pas diploma universitare (10.5%), të tjerët 9.1% kanë kryer 3 vjet të shkollës së mesme të zejtarisë/profesionale, 7.7% shkollim të lartë, 6% kanë pas 1-4 vjet të arsimit fillor, 3.6% nuk kanë pas fare arsimim dhe pjesa e mbetur prej 1.3% kanë pas shkollim postdiplomik.

3.1. SITUATA ME REGJISTRIMIN E VDEKJES NË KOSOVË

Prej gjithsej 1149 të anketuarve që kanë pohuar se kanë pas rast të vdekjes në familjen e tyre në 3 vitet e fundit (dhjetor 2007 – dhjetor 2010), 59% e të vdekurve kanë qenë meshkuj dhe 41% femra.




Fig. Rastet e vdekjes sipas gjinive

Pjesa më e madhe e vdekjeve të raportuara (65.4%) kanë ndodhur jashtë shtëpisë brenda territorit të Kosovës, pasuar me vdekjet që kanë ndodhur në spitale të Kosovës (26%). 63% e

³ UNFPA, 2009, Vlerësimi i Sistemit të Regjistrimit Vital të Kosovës


të anketuarve pohojnë se e kanë thirrur personin përgjegjës (mjekun) për të konfirmuar vdekjen, përderisa të tjerët nuk e kanë bërë këtë. Megjithatë, ky nuk ka qenë rasti në mesin e Serbëve. Më shumë se gjysma e tyre kanë thënë se nuk e kanë thirrur mjekun për të vërtetuar/konfirmuar vdekjen e personit. Situata e ngjashme është edhe me romët, përderisa numër më i madh i boshnjakëve dhe turqve kanë theksuar se e kanë bërë këtë.

3.2. REGJISTRIMI DHE ÇERTIFIKATA E VDEKJES

Sipas Ligjit mbi Regjistrat e Gjendjes Civile, Regjistrat e Vdekjes janë libra në të cilët mbahen shënimet rreth vdekjeve që kanë ndodhur. Përderisa, Certifikata e Vdekjes është dokument zyrtar i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, si dëshmi e të dhënave që gjenden në librat e Regjistrave të Gjendjes Civile.

3.2.1. Certifikata e vdekjes dhe komunitetet etnike

Pjesa më e madhe e të anketuarve (60.6%) kanë pohuar se e kanë regjistruar personin e vdekur në Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe se një pjesë e tyre (24%) nuk e kanë regjistruar personin e vdekur. Pjesa më e madhe e të anketuarve jo-shqiptarë të cilët nuk e kanë regjistruar personin e vdekur, i përkasin nacionalitetit Serb, apo 49% e të gjithë të anketuarve jo-shqiptarë që nuk e kanë regjistruar personin e vdekur.



Prej atyre Serbëve të cilët e kanë kryer regjistrimin e personit të vdekur, gati gjysma e tyre kanë thënë se këtë regjistrim e kanë kryer me autoritetet serbe të pas viteve 1999 që operojnë në Kosovë dhe 23.07% regjistrimin e kanë kryer me autoritetet (institucionet) serbe që operojnë në Serbi dhe këto janë kryesisht rastet e vdekjeve që kanë ndodhur jashtë Kosovës, gjë që

mund të shpjegojë se pse këto vdekje nuk janë regjistruar në Kosovë. Pjesa e mbetur prej 18% kanë thënë se regjistrimin e kanë kryer me institucionet e Kosovës.




Fig.2.1 Institucioni i regjistrimit te vdekjes ne mesin e te anketuarve serb

Pjesa më e madhe e komuniteteve tjera jo-serbe, e kanë kryer regjistrimin me institucionet e Kosovës.

Gjatë diskutimit në Fokus Grupe, të gjithë pjesëmarrësit janë patuar se të gjitha llojet (mënyrat) e vdekjeve duhet të regjistrohen (aksidentet, vetëvrasjet, vrasjet, etj.) Kjo çështje është ngritur më tepër për të testuar perceptimin e tyre mbi regjistrimin. Anët pozitive të kësaj përfshijnë kontributin në statistikat zyrtare, zvogëlimi i rrezikut të keqpërdorimi të listave të votuesve dhe pensioneve, taksave dhe tarifave të shërbimeve komunale të cilat kalkuloohen në bazë të numrit të anëtarëve të familjes, çështjeve që kanë të bëjnë me pronën e kështu me radhë.

3.2.2. Certifikata e vdekjes në vendbanimet urbane dhe rurale

Për më tepër, sa i përket vendbanimit, një pjesë më e madhe e të anketuarve nga pjesët rurale nuk e kanë regjistruar personin e vdekur, krahasuar me pjesët urbane. Gjithashtu, familjet me nivelin mesatar apo nën-mesatar të të ardhurave, janë në mesin e atyre që nuk e kanë kryer regjistrimin e personit të vdekur. Tri arsyt kryesore të përmendura nga të anketuarit për mos-regjistrim, janë: 1) mungesa e njohurisë së procedurave për marrjen e Certifikatës së Vdekjes (19%), 2) mungesa e njohurisë nëse nevojitet Certifikata e Vdekjes apo jo (17%) 3) kostoja e lartë e regjistrimit (14.5%).

Gjatë hulumtimit kualitativ me pjesëmarrësit nga vendbanimet rurale të cilët nuk e kanë regjistruar personin e vdekur në zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile, arsytet e përgjithshme të theksuara për mos-regjistrim të vdekjeve janë neglizhenca dhe mungesa e vetëdijes për këtë përgjegjësi. Largësia e fshatit nga vendi ku bëhet regjistrimi, është po ashtu një faktor për mungesën e këtij vetëdijesimi. Vdekjet që kanë ndodhur në shtëpi nuk konfirmohen nga mjekët. Për ato që ndodhin në spital lëshohet një fletë-lëshim, por nuk bëhet asnjë përcjellje e këtij informacioni në Zyrën e Komunës. Gjithashtu, nuk ka ndonjë njohuri nëse ekziston zyra për regjistrimin e vdekjes në spital, por një gjë e tillë është konsideruar si e dobishme.

3.3. SHKALLA E REGJISTRIMIT TË VDEKJES

Shkalla më e lartë e regjistrimit të vdekjes është vërejtur në regjionin e Pejës, ku 77.03% e të anketuarve kanë pohuar se e kanë kryer regjistrimin, pasuar nga Gjilani (71.11%) dhe Prizreni (67.78). Shkalla më e ulët e regjistrimit është në regjionin e Mitrovicës, kur rreth 24% e të anketuarve kanë pohuar se e kanë regjistruar personin e vdekur.

Afro një përqind e të anketuarve, apo më saktësisht 18 prej tyre kanë raportuar se kanë pas rast vdekje të foshnjave (prej 12 muajsh e me pak), në familjen e tyre në 3 vitet e fundit. 15 prej tyre kanë theksuar se e kanë regjistruar foshnjën në Regjistrin e Lindjes, përderisa 3, jo. Prej 15 të anketuarve të cilët e kanë regjistruar lindjen e foshnjës, 14 prej tyre e kanë bërë edhe regjistrimin e vdekjes dhe kanë marrë certifikatën e vdekjes me rastin e vdekjes së foshnjës, duke e lënë kështu vetëm një të anketuar që pohon se nuk e ka bërë regjistrimin e vdekjes së foshnjës.

Pjesa më e madhe e të anketuarve shqiptarë e kanë kryer regjistrimin me institucionet e Kosovës, përderisa Serbët kanë raportuar më shumë raste të regjistrimit të Vdekjes me autoritet serbe të pas vitit 1999, që operojnë në Kosovë.

3.4 KËRKESAT E REGJISTRIMIT TË VDEKJES

Afati mesatar, i raportuar nga të anketuarit, për regjistrimin e faktit të vdekjes në Zyrën e regjistrimit të Gjendjes Civile, është 25 ditë, ashtu siç raportohet nga të anketuarit. 60.29% e të anketuarve mendojnë se nuk ka ndonjë masë ligjore/tarifë për regjistrimin e vonshëm të faktit të vdekjes. Vetëm afro 17% besojnë se ka. Neni 33.10 i **Ligjit No. 02/L-126 Për Ndryshimin**

dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/46 Për Regjistrat e Gjendjes Civile, thekson se në rast të regjistrimeve të vonshme në regjistrin e vdekjes, regjistrimi mund të bëhet vetëm me vendimin e organit komunal përgjegjës për gjendjen civile.

3.5. REGJISTIRMI ME KOHË DHE AI I VONSHËM

Pjesa më e madhe e të anketuarve, apo 48% e tyre, e kanë kryer regjistrimin për më pak se një muaj (ku pjesa më e madhe e këtyre janë nga regjioni i Pejës, 37.3%) apo për më pak se një javë (32 %), ku pjesa më e madhe e këtyre janë nga regjioni i Prishtinës (41%). Shumica (52%) kanë thënë se arsyeja për regjistrimin me kohë ka qenë se është obligim i tyre dhe pjesa tjetër 31% kanë thënë se këtë e kanë bërë për shkak se kjo është praktika e zakonshme në rrethin e tyre.




Fig.3 Koha e regjistrimit të vdekjes

Arsyeja më e përmendur për regjistrim të vonshëm, në mesin e atyre që nuk e kanë kryer regjistrimin brenda afatit të caktuar, ka qenë se ata nuk kanë pas kohë, apo se nuk kanë pas dijeni se duhet të bëhet një gjë e tillë. Kur janë pyetur nëse janë në dijeni se a ka ndonjë dënim për regjistrim të vonshëm (pra nëse regjistrimi i vonshëm ka më shumë kërkesa, apo kushton më shumë), 32% e tyre kanë thënë se nuk kanë qenë në dijeni nëse ka ndonjë dënim për regjistrim të vonshëm dhe afro 52% e tyre kanë thënë se ky fakt do të ndikonte në vendimin e tyre për ta regjistruar personin tjetër që vdesë në familjen e tyre, brenda afatit prej 30 ditësh, ashtu si edhe kërkohet. Vetëm disa prej tyre (14%) kanë thënë se ky informacion nuk do të ndikonte në vendimin e tyre të ardhshëm për regjistrimin me kohë të faktit të vdekjes.




Fig.4. Vetëdijesimi për regjistrimin e vonshëm

Hulumtimi kualitativ me pjesëmarrësit nga vendbanimet rurale që e kanë kryer regjistrimin, ka zbuluar se në përgjithësi të gjithë pjesëmarrësit kanë thënë se e kanë regjistruar vdekjen e personit brenda një apo dy javësh nga dita kur ka vdekur. Edhe pse ata nuk ishin në dijeni për afatit kohor për regjistrim prej 30 ditësh, ata sërish e kanë bërë këtë sepse ashtu është praktika në familjen e tyre. Pjesëmarrësit nga vendbanimet urbane pohojnë se e kanë kryer regjistrimin me kohë, për shkak se kanë qenë në dijeni për obligimin e tyre. Arsyet e përmendura nga pjesëmarrësit për mos regjistrimin e vdekjes së anëtarit të familjes së tyre, ishte mungesa e kohës, apo ndoshta periudha e shkurtë kohore që nga vdekja e personit, kur familja ende është në zi për atë person.

3.6. VENDI I REGJISTRIMIT TË FAKTIT TË VDEKJES

Sipas Ligjit mbi Regjistrat e Gjendjes Civile, fakti i vdekjes regjistrohet në vendin ku ka ndodhur vdekja. 34% e të anketuarve kanë thënë se ata kanë bërë kërkesë për Certifikatën e Regjistrimit të Vdekjes në Komunë, Zyrën për Regjistrimin e Gjendjes Civile të vendit ku ka ndodhur vdekja, përderisa 29% kanë thënë se kanë aplikuar për Certifikatën e Vdekjes në vendin ku ka jetuar i ndjeri/e ndjera.




Fig.5 Vendi i regjistrimit të faktit të vdekjes

3.7. BURIMI I INFORMACIONIT MBI PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË VDEKJES

Burimi kryesor i informacionit për regjistrimin e vdekjes dhe për dokumentet e nevojshme për kryerjen e procesit (58.6%) janë Nëpunësit në Zyrën e Gjendjes Civile / Departamenti për Regjistrim dhe rreth 30% kanë thënë se ky burim ka qenë Tabela e Informatave që gjendet në objektin e kësaj zyre. Vetëm 11.3% e tyre kanë thënë se këto informacione mbi procesin dhe dokumentet e nevojshme për marrjen e Certifikatës së Vdekjes i kanë marrë nga familja, shoqëria dhe miqtë. Pjesa më e madhe e të anketuarve (67%) këtë informacion e kanë vlerësuar si të dobishëm.




Fig.6 Burimet primare të informacionit për regjistrimin e vdekjes

Një pjesë e madhe e të anketuarve e dinin se cilat dokumente nevojitet për të regjistruar personin e vdekur në regjistrin e vdekjes. Në pyetjen nëse e dinin se ku duhet të merren certifikata si ajo e lindjes, martesës dhe letërnjoftimet, pothuajse të gjithë kanë thënë që këto merren në Komunë. Ata gjithashtu e dinin se fletë-lëshimi i spitalit, merret pikërisht në spital / institucionin shëndetësor.

Megjithatë, gjatë diskutimit me pjesëmarrësit e Fokus grupit që vinin nga pjesët rurale, e të cilët nuk e kishin kryer regjistrimin e vdekjes, u kuptua që pjesa më e madhe e tyre nuk e dinin saktësisht se ku gjendet zyra e regjistrimit të gjendjes civile.

3.8. PËRVOJA ME PROCESIN E REGJISTRIMIT TË VDEKJES

Përvoja e gjithëmbarshme me regjistrimin e personit të vdekur, nga ana që e kanë bërë një gjë të tillë, nuk konsiderohej as si e lehtë por as e vështirë (37.5%), më shumë se gjysma e të anketuarve kanë thënë që procedura nuk ka qenë as e ngadalshme, por as e shpejtë.




Fig.7 Përvoja me procesin e regjistrimit

Një pjesë e madhe e tyre kanë thënë që i kanë kaluar 15-30 minuta në Komunë / Zyrën për Regjistrimin e Gjendjes Civile. Afro 43% kanë thënë që atyre iu është dashur që të vizitojnë Komunën/ Zyrën e Regjistrimit të Gjendjes Civile, më shumë se një here, për ta kryer procesin e regjistrimit. Më shumë se gjysma kanë thënë që nuk kanë pas mjaft informacione rreth asaj se çfarë nevojitet për të kryer procesin e regjistrimit, para vizitës së tyre të parë. Informacioni ka qenë më i qartë pas vizitës së parë dhe të dytë, siç pohojnë 78% e të anketuarve. Komuna /

Zyra e Regjistrimit të Gjendjes Civile, është vendi ku janë gjasat më të mëdha për të marrë informacionet e nevojshme mbi kërkesat për kryerjen e procesit të regjistrimit.

Pjesëmarrësit e Fokus Grupit që vinin nga pjesët rurale kanë deklaruar që ata ishin të informuar për dokumentet e nevojshme për regjistrimin e vdekjes. Aty po ashtu u tha që në një instance regjistrimi i personit të vdekur ishte kryer edhe pa certifikatën e vdekjes. Ka qenë një rast që është përmendur gjatë diskutimit me pjesëmarrësit nga pjesët urbane të cilët e kanë kryer regjistrimin, kur njërit nga këta pjesëmarrës i vdesë gjyshja nga Sanxhaku, përderisa ajo ishte në vizitë te vajza e saj në Prishtinë. Vdekja ka ndodhur në spital. Spitali e lëshon vërtetimin e vdekjes, por se kjo nuk mjafton për të transferuar trupin jashtë Kosovës, për në Sanxhak. Atyre iu është dashur që të marrin Certifikatën e Regjistrimit të Vdekjes, gjë që ka qenë e vështirë të bëhet për shkak se të nesërmen ka qenë ditë e shtunë dhe Zyra për Regjistrimin e Gjendjes Civile nuk punon gjatë ditëve të fundjavës. Megjithatë, me disa lidhje ata kanë arritur që ta marrin këtë certifikate. Për shkak të këtyre rasteve kur vdekja ndodhë një ditë para fundjavës dhe se trupi duhet të transferohet në ndonjë vend tjetër jashtë Kosovës, nuk ka mundësi që kjo të bëhet pa një certifikate të vdekjes. Prandaj, gjatë këtyre diskutimeve është sugjeruar që zyrat e regjistrimit civil të punojnë edhe të shtunave dhe se orari i tyre i punës të zgjatet më shumë edhe ditëve të tjera.

3.9. PERCEPTIMI MBI PUNËN E KOMUNËS/CENDRAVE PËR REGJISTRIM TË GJENDJES CIVILE

37.6% e të anketuarve duhet se janë deri diku të kënaqur me koston e regjistrimit të personit të vdekur në Regjistrin e Vdekjes.

Një pjesë e madhe të anketuarve (42.4%) janë shumë të kënaqur me kohën që nevojitet për t'i marrë këto shërbime.

45% kanë thënë se janë shumë të kënaqur me saktësinë e të gjitha të dhënave në libër.

44.3% e të anketuarve kanë deklaruar se janë shumë të kënaqur me qasjen në të dhëna/informacione.

Një pjesë e madhe e tyre është gjithashtu e kënaqur me punën e personelit (45.1%)

Gati gjysma e tyre (46.4%) është shumë e kënaqur me mirësjelljen e personelit.

45.4% e pjesëmarrësve janë të po ashtu shumë të kënaqur me qasjen e personelit.

44% janë të kënaqur me punën e gjithëmbarshme të Zyrave të Regjistrimit të Gjendjes Civile.

Një pjesë e madhe e të anketuarve (42.1%) janë shumë të kënaqur me orarin e punës së institucioneve.

Pjesëmarrësit në Fokus grupe kanë thënë që koha që nevojitej për të kryer këtë procedure, ashtu siç thuhej nga përvoja e tyre, nuk është e gjatë (brenda ditës) dhe kostoja që përfshihet është rreth 5-6 euro.

3.10. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE PËRKATËSIA ETNIKE

Një pjesë e madhe (89%) nuk ka përjetuar ndonjë vonesë apo vështirësi gjatë procesit të regjistrimit të vdekjes, për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Situate e njëjtë është edhe me të anketuarit tjetër jo-shqiptarë. Gjithashtu, gati asnjë lloj diskriminimi nuk është raportuar në baza të gjinisë dhe statusit ekonomik.

3.11. SHTYTJA PËR REGJISTRIMIN E VDEKJES

Tri gjërat kryesore që do të mund t'i bënin njerëzit të regjistrojnë faktin e vdekjes së personit në familjen e tyre, janë:

1. thjeshtësimi i procedurave (32.52%)
2. shpërndarja e informacionit mbi regjistrimin e vdekjes (15.32%). Për komunitetin boshnjak, shtytja e dytë sipas prioritetit është që 'Qendrat të jenë më të qasshme', përderisa për romët dhe turqit, 'të shpërndahen më shumë informacione rreth regjistrimit të vdekjes'.
3. të mundësohet asistencë (stimulimi) social (shtetëror) për shpenzimet e varrimit (11.80%). Kjo e dyta i referohet mundësisë që të merret një lloj asistence monetare për të mbuluar një pjesë të (apo tërë) shpenzimet e varrimit, me kërkesën që i ndjeri/e ndjera të regjistrohet në regjistrin e vdekjes.

Megjithatë, në mesin e të anketuarve serb shtytja e tretë me prioritet për regjistrimin e vdekjeve, do të ishte që të mundësohet regjistrimi i vdekjes së personit në vendin ku ai/ajo ka banuar para vdekjes.

3.12. INKURAJIMI I AUTORITETEVE PËR REGJISTRIMIN E VDEKJES

Duket që nuk ka ndonjë inkurajim nga ana e autoritete për regjistrimin e fakteve të vdekjes. Të anketuarit (82%) kanë raportuar që nuk kanë pas ndonjë rast kur mjekët apo stafi i spitalit, nëpunësit e komunës, apo udhëheqësit religjioz, i kanë shtyrë ata që ta kryejnë këtë regjistrim.




Fig.8 Inkurajimi i autoriteteve për regjistrimin e vdekjes

Prej atyre që kanë pohuar se nuk kanë pas përvojë të tillë, më shumë se gjysma (56.39%) kanë thënë se këto autoritete vetëm kanë përmendur se duhet ta regjistrojnë personin e vdekur dhe 39% kanë thënë se ishin informuar shkurtimisht se si duhet ta bëjnë këtë regjistrim.




Fig.8.1 Informacionet e dhëna nga autoritetet mbi regjistrimin e vdekjes

Është pothuajse gjithmonë traditë që personat e vdekur të varrosen me rituale religjioze. 90.5% e të anketuarve e kanë bërë këtë. Megjithatë, vetëm disa prej tyre (9.9%) kanë deklaruar se udhëheqësi fetar u ka kërkuar që të regjistrojë informacionin rreth personit të vdekur para se të vazhdojë me ceremoninë e varrimit. Ka pas disa raportime nga përvoja e tyre, gjatë diskutimit në fokus grupe, që institucionet religjioze i kanë mbajtur shënimet e tyre, edhe pse të gjithë janë pajtuar që ata duhet gjithmonë t'i mbajnë këto shënime. Institucionet religjioze do të mund

të përfshiheshin më shumë në informimin e popullatës për kërkesën e regjistrimit të personit të vdekur dhe se do të mund të kishte edhe më shumë koordinim në mes tyre dhe Komunës, në çështjet si regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, pasi edhe ato i kanë disa shënime të veta.

3.13. VETËDIJËSIMI / INFORMACIONET RRETH REGJISTRIMIT TË VDEKJES

Një pjesë e madhe e të anketuarve besojnë që nuk do të duhej të ishte përgjegjësi e Qeverisë që të ngritë vetëdijen rreth regjistrimit të vdekjes. Vetëm numër më i madh i të anketuarve nga komuniteti boshnjak besojnë që është do të duhej të ishte përgjegjësi e tyre (38%). Njerëzit që janë përgjegjës për informimin e të tjerëve mbi këtë kërkesë të regjistrimit, siç u diskutuar gjatë fokus grupeve, do të duhej të ishin mjekët kur të konfirmojnë vdekjen, udhëheqësit fetar kur të kryejnë ceremoninë e varrimit, nëpunësit komunal në Zyrat e Regjistrimit Civil. Duhet të ketë një fushatë vetëdijesimi mbi Regjistrimin e Vdekjes, përmes medieve të shtypura, apo televizionit, fletushka apo edhe vizita derë më derë. Në anë tjerët, pjesëmarrësit e fokus grupeve nga pjesët rurale, të cilët nuk e kanë kryer regjistrimin, besojnë se fushata duhet të udhëhiqet nga Qeveria, por se ka edhe palë tjera të involvuara të cilët do të mund të kontribuonin në këtë drejtim. Këta janë mjekët në spital të cilët do të mund të informonin anëtarët e familjes së ngushtë mbi obligimin e tyre për të regjistruar personin e vdekur, apo edhe udhëheqësit fetar do të mund të angazhoheshin në një aktivitet të tillë me xhematin/famullinë e tyre. Informacionet që nevojiten ndërliqhen me vendin ku bëhet regjistrimi i vdekjes, dokumentet e nevojshme, kostoja që përfshihet, afati i fundit, ndëshkimet për regjistrim të vonshëm dhe koha që nevojitet për ta kryer këtë.

Burimet e informacioneve që përdoren më së shumti nga pjesëmarrësit, janë interneti, gazeta dhe televizioni. Kanali më së larti i radhitur për regjistrimin e vdekjes është televizioni (43%), përcjellë nga media e shtypur (36%).

4. PËRFUNDIMET

- Përkundër kërkesave ligjore për të t'i regjistruar të gjitha faktet e lindjes dhe vdekjes, ende ekziston një përqindje e lartë e popullatës të cilët nuk e kanë kryer obligimin e tyre për të regjistruar personin e vdekur.
- Duket se ende ekziston një hezitim nga komuniteti serb për të regjistruar faktin e vdekjes në institucionet e Kosovës, gjë që nuk është rasti me komunitetet tjera jo-serbe.

- Ekziston një mungesë e vetëdijesimit rreth nevojës për të thirr mjekun apo personin tjetër përgjegjës, për të vërtetuar/konfirmuar vdekjen e një personi, kur kjo ndodhë jashtë institucioneve shëndetësore.
- Rezultatet tregojnë se në përgjithësi vdekjet e foshnjave (më të reja se 12 muaj) raportohen / regjistrohen pa marrë parasysh se cila është gjinia e tyre.
- Ekziston një shkallë më e ulët e regjistrimit të vdekjes në mesin e njerëzve që jetojnë në pjesët rurale dhe të atyre që kanë të ardhura më të ulëta. Largësia nga zyrat e regjistrimit është një nga arsyet më kryesore.
- Në përgjithësi, mungesa e informacionit mbi kërkesat dhe procedurat e kryerjes së Regjistrimit të Vdekjes, si dhe kostoja e përfshirë është një ndër arsyet kryesore të mos-regjistrimit.
- Nëpunësit dhe Tabelat informative në Zyrat e Regjistrimit të Gjendjes Civile, janë burimi kryesor i informative rreth regjistrimit të vdekjes.
- Zyrat e Regjistrimit të Gjendjes Civile duket se po kryejnë punë të mire dhe pa diskriminim në baza etnike.
- Nëpunësit komunal në Zyrat e Regjistrimit Civil duhet të jenë mënyra e pare për rritjen e vetëdijes mbi regjistrimin e vdekjes, pasuar nga mjekët në spital dhe udhëheqësit religjioz.
- Ekziston nevoja për më shumë koordinim në mes institucioneve religjioze, të shëndetësisë dhe ato qeveritare, kur është fjala për informimin e popullatës rreth kërkesës për të regjistruar faktin e vdekjes. Secila prej këtyre institucioneve do të mund të kryente procesin e regjistrimit të vdekjes dhe të bëjnë shkëmbimin e informacioneve (bazës së të dhënave) mbi rastet e regjistrimit të vdekjes.

SHTOJCA 1

Metodologjia e Hulumtimimit

Për implementimin e kësaj analize janë përdorë dy metoda:

- Hulumtimi kuantitativ përmes anketimit, me personat të cilat kanë pas raste të vdekjes në familjen e tyre në tri vitet e fundit (që nga dhjetori i vitit 2007).
- Hulumtimi kualitativ – përmes diskutimeve në Fokus grupe ⁴ të cilat kanë dhënë informata më të hollësishme prapavijëse në lidhje me çështjen. Diskutimi ishte kryer me pjesëmarrësit nga pjesët urbane dhe rurale, si ata që e kanë kryer regjistrimin e vdekjes së personit në familjen e tyre, ashtu edhe me ata të cilët nuk e kanë bërë këtë.

Hulumtimi kuantitativ

Metoda e intervistimit

Anketa ishte realizuar përmes intervistave ballë-për-ballë. Sipas udhëzimeve specifike, intervistuesit janë udhëzuar që të shkojnë në adresa të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme për t'i kryer intervistat (teknika e ecjes së rastësishme) dhe që t'i identifikojnë dhe përzgjedhin anëtarët e familjeve të veçanta, me të cilët di të realizoheshin intervistat (me prindërit, gjyshërit apo kujdestarët/et).

Struktura dhe dizajni i pyetësorit

Prism Research ka zhvilluar pyetësorin, me disa inpute nga UNFPA.

Metodologjia dhe procedura e përzgjedhjes së mostrës

Për qëllimin e këtij hulumtimi është zhvilluar mostra e shtresuar në tri faza. Kujdes i është përkushtuar të sigurohet që të gjithë parametrat e caktuar të mostrës të jenë të përmbushur: sipas pjesëve me shumicë të caktuar të përkatësisë etnike (pjesët me shumicë shqiptare dhe serbe), sipas regjioneve dhe llojit të vendbanimit (urban/rural). Intervistat janë realizuar në të gjitha komunat në çdo regjion. Numri I intervistave për çdo komunë ishte përcaktuar në bazë të

⁴ KLAUZOLA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE TË TË ANKETUARIT

Prism Research, në pajtim me rregullat dhe rregulloret e ESOMAR dhe AAPOR, është e obliguar që të mbrojë anonimitetin e të anketuarve. Të gjitha pyetjet / variablat që përmbajnë çfarëdo lloj informacioni rreth identitetit të të anketuarve, janë të larguara nga raporti dhe baza finale e të dhënave. Kjo do të thotë që përgjigjet e dhëna nga të anketuarit janë fizikisht të ndara nga raporti dhe baza përfundimtare e të dhënave. Çdo lloj përpjekje e qëllimshme për të identifikuar të dhënat e të anketuarve, qoftë nga ana e Klientit, Prism Research, apo çdo pale e tretë, do të konsiderohet si shkelje serioze dhe do të trajtohet si e tillë.

popullatës së komunës (numri i votuesve të regjistruar në çdo komunë). Si rrjedhojë, më pak intervista janë realizuar në komunat me më pak popullate dhe më shumë në ato me më shumë popullate.

Mostra ishte dizajnuar sipas ndarjes administrative dhe territoriale të KFOR-it (në pjesët me shumicë shqiptare KFOR-i Britanez – Prishtinë, Francez – Mitrovicë, KFOR-I i SHBA-ve – Gjilan, KFOR-i Gjerman – Prizren dhe ai Italian – Pejë, si dhe në Veri – Mitrovicë, Qendër – Fushë Kosovë dhe Graçanicë, Lindje – Novo Bërd dhe Kamenicë, dhe Jug – Shtërpçë).

Mostra për secilën komunë është nxjerrë nga regjistri civil i marrë nga OSCE-ja. e janë analizuar sipas rajoneve të zhvilluara nga institucionet e Kosovës (rajoni i Prishtinës, Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit, Ferizaj, Gjilanit dhe Pejës), kjo do të duhej ta bënte mostrën përfaqësuese në nivelin e komunës, ashtu edhe në nivelin e rajonit.

Prandaj, mostra ka përfshirë 900- shqiptarë të Kosovë, 100-serbë të Kosovës dhe 150 grupe tjera etnike jo-serbe. Gjithashtu duhet përmendur që grupet e minoriteteve (posaçërisht komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas) janë mbi-përfaqësuar në këtë mostër. Prandaj, duhet përmendur që çdo komuniteti etnik jo-serb, l është caktuar kuota prej 50 të anketuarve. Duhet përmendur që grupi etnik l romëve, gjithashtu ka përfshirë ashkalinjët dhe egjiptasit, përderisa grupi etnik l boshnjakëve ka përfshirë edhe myslimanët dhe goranët. Kjo ka bërë të mundur që të arrihen konkluzione mbi praktikën e ndryshme të (mos) regjistrimit të rasteve të vdekjes në mesin e grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Po të ishte përdorur një qasje tjetër, do të ishte shumë më e vështirë që të dëshmohet dallimi në mes grupeve të ndryshme etnike.

Karakteristikat kryesore të mostrës

Anketa ishte realizuar në mostër prej 1,150 pjesëmarrësve, të cilët në tri vitet e fundit (që nga dhjetori l vitit 2007) kanë pas rast të vdekjes në familjen e tyre.

Tabela 1. Karakteristikat kryesore të mostrës sipas ekonomive familjare

		Pjesët me shumicë shqiptare		Pjesët me shumicë serbe	
		1015	88.2%	135	11.8
GJITHSEJ		1150			
		N	%		
Regjioni	Regjioni i Prishtinës	310	26.95		
	Regjioni i Mitrovicës	196	17.05		
	Regjioni i Prizrenit	235	20.44		
	Regjioni i Gjilanit	196	17.04		
	Regjioni i Pejës	213	18.52		
Grupet etnike	Shqiptarë	900	78.27		
	Serb	100	8.9		
	Boshnjak	50	4.34		
	Turk	50	4.34		
	Rom, Ashkali dhe Egjiptas	50	4.34		
	Të tjerë				

Intervistuesit dhe procedura e intervistimit

Ekipi i terrenit për këtë hulumtim ka përfshirë 7 koordinatore regjional (5 për pjesët me shumicë shqiptare dhe 2 për pjesët me shumicë serbe), 45 intervistues (38 për pjesët me shumicë shqiptare dhe 7 për pjesët me shumicë serbe), pesë kontrollues të terrenit dhe një kontrollues përmes telefonit. Ata janë përzgjedhur në bazë të shkathtësive të tyre të mëparshme, moshës, gjinisë dhe prejardhjes regjionale, për të siguruar mundësi të barabarta / për të përfaqësuar përbërjen e ndryshueshme të popullatës. Koordinatorët dhe pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në një sesion trajnimi një ditë, që ka përfshirë shpjegimin e qëllimit të projektit, rishikimin pjesë për pjesë të pyetësorit dhe provat e intervistimit me intervistuesit tjerë.

Sondazhi ka filluar me 3 dhjetor 2010 dhe ishte kryer me 15 dhjetor 2010. Pas kontaktimit të familjes së duhur dhe identifikimit të respondentëve, intervistuesit kanë prezantuar veten, Agjencinë Prism Research dhe kanë dhënë shpjegim të shkurtë mbi qëllimin e hulumtimit. Pas kësaj, ata i kanë informuar respondentët rreth procedurës së intervistimit dhe kanë filluar me intervistë. Intervistuesit i kanë lexuar pyetjet nga pyetësori, në të cilin gjithashtu i kanë regjistruar përgjigjet.

Përderisa e kanë realizuar anketimin, intervistuesit kanë hasë në disa vështirësi të vogla, sa i përket gatishmërisë së popullatës për të marrë pjesë, posaçërisht pasi që pjesëmarrësit janë informuar rreth qëllimit të kësaj ankete. Kjo ka qenë kryesisht për shkak se anketa është

realizuar disa ditë para dhe gjatë zgjedhjeve të përgjithshme dhe prandaj njerëzit kanë qenë paksa skeptikë për qëllimin e anketës. Megjithatë, intervistuesit kanë arritur shumë mire që t'i eliminojnë ato dyshime duke u shpjeguar që ky hulumtim nuk ka të bëjë asgjë me zgjedhjet (atëherë) të ardhshme. Ka qenë vetëm rastësi që koha e realizimit të këtij hulumtimi të koincidojë me zgjedhjet. Prandaj, shkalla e përgjigjes (përqindja e respondentëve të cilët kanë marrë pjesë në anketë dhe numri total i respondentëve të kontaktuar apo që kanë qenë në dispozicion) qëndron në 70 %, duke e bërë mostrën tejet përfaqësuese të realitetit të shkallës së regjistrimit të vdekjes në Kosovë.

Tabela e mëposhtme përmban informatat nga formularët e kontaktit që kanë të bëjnë me rezultatin përfundimtar të kontaktit të respondentëve të arritur nga ana e intervistuesve.

Pjesët me shumicë shqiptare

Rezultati i Kontaktit	Frekuenca	Përqindja
1 – Intervista të kryera	1015	70.18
2 – Refuzimi në nivel të ekonomisë familjare, intervista e refuzuar nga personi që ka hapur derën	135	9.4
3 – Refuzim nga anëtar i ekonomisë familjare i përzgjedhur për intervistë	40	2.8
4 – Askush nuk përgjigjet në derë	47	3.3
5 – Intervistuesi i bën dy vizita, por nuk mund të gjejë në shtëpi anëtarin e familjes të përzgjedhur për intervistë	40	2.9
6 – Ekonomia familjare nuk i përmbushë kriteret për t'u intervistuar	35	2.5
7 – Hapësirë biznesi, restorant/bar, organizatë apo agjenci qeveritare	45	3.12
8 – Askush nuk jeton në këtë adresë	43	2.95
9 – Arsye tjera për mos kryerjen e intervistës	41	2.85
Total	1441	100 %

Pjesët me shumicë serbe:

Rezultati i kontaktit	Frekuenca	Përqindja
1 – Intervista e kryer	135	23.76
2 – Refuzimi në nivel të ekonomisë familjare, intervista e refuzuar nga personi që ka hapur derën	67	11.79
3 – Refuzim nga anëtar i ekonomisë familjare i përzgjedhur për intervistë	53	9.34
4 – Askush nuk përgjigjet në derë	55	9.7

5 – Intervistuesi i bën dy vizita, por nuk mund të gjejë në shtëpi anëtarin e familjes të përzgjedhur për intervistë	53	9.33
6 – Ekonomia familjare nuk i përmbushë kriteret për t'u intervistuar	51	8.97
7 – Hapësirë biznesi, restorant/bar, organizatë apo agjenci qeveritare	42	7.4
8 – Askush nuk jeton në këtë adresë	54	9.50
9 – Arsye tjera për mos kryerjen e intervistës	58	10.21
Gjithsej	568	100

Është e nevojshme të përmendet që vet hulumtimi i opinionit ka pas ndikim pozitiv, pra, që pyetësi ishte dizajnuar në atë mënyrë që të rrisë vetëdijen e pjesëmarrësve rreth rëndësisë së regjistrimit të vdekjes dhe gjithashtu që t'i jep atyre informacionet mbi procedurat e tij. Pjesa më e madhe e të anketuarve të cilët kanë marrë pjesë në diskutimet e Fokus Grupeve, kanë thënë që pas këtij diskutimi ata do ta shqyrtojnë seriozisht regjistrimin (me kohë), në rast se kanë ndonjë rast tjetër të vdekjes në familjen e tyre. Disa, të cilët nuk e kanë bërë ende regjistrimin, kanë thënë që do ta kryejnë këtë brenda disa ditëve (pas mbajtjes së fokus grupit).

Kontrollimi i të dhënave

Siç është përmendur më sipër, secili intervistues është dashtë që të kryejë së paku një intervistë me apo pa praninë e koordinatorit. Puna e intervistuesve është kontrolluar në dy mënyra: pasi që është plotësuar anketa, kontrolluesit kanë filluar punën në terren për të kontrolluar në bazë të informacionit të dhënë në formularët e kontaktit dhe ata kontrollues, për të parë nëse intervistuesi i ka përcjellë rregullat e përcaktimit të mostrës, si dhe qasjen e sjelljen e tij/saj gjatë intervistës. Gjithashtu, gjatë kryerjes së punës në terren, koordinatorët regjional kanë kontrolluar çdo pyetësor të plotësuar pas dorëzimit, për të zvogëluar gjasat e pyetësorëve të plotësuar gabimisht, apo që gabimet sistematike të intervistuesve të shkojnë të pakontrolluara.

Procedimi dhe analiza e të dhënave

Tërë futja e të dhënave është kryer në zyrat e Prizmit në Prishtinë. Për futjen e të dhënave është përdorë një maskë e veçantë e programit të softuerit të softuerit të Survey System.

Pas futjes së të dhënave, të dhënat janë transferuar dhe analizuar me programin SPSS (Software Program for Social Sciences) – që është një pako profesionale softuerike për hulumtimin e opinionit publik. SPSS gjithashtu është përdorë për pastrimin e të dhënave dhe

për kontroll logjik, si dhe për prezantimin tabelor të kryqëzimeve të rezultateve. Procedimi dhe analiza e të dhënave dhe shkruarja e raportit ishte ndihmuar nga zyra qendrore e Prism Research në Sarajevë.

Duhet të theksohet se vetëm dallimet statistikiisht domethënëse në mes të ndryshoreve janë përmendur, ku dallimet statistikiisht domethënëse theksojnë dallimin ku probabiliteti i fitimit të dallimit të tillë aksidentalisht është 5% apo më pak se 5%, p.sh. po që se $p \leq 0,05$. Po që se dallimi me probabilitet më të lartë është përmendur në raport, është shoqëruar me përshkrim përkatës.

Hulumtimi kualitativ

Përmes fokus grupeve kemi kuptuar më hollësisht gjithë prapavijën e opinionëve dhe qëndrimeve, arsyeve, motivimin e grupeve në fokus lidhur me çështjen e cila është hulumtuar. Për më tepër, intervistat janë mënyrë efikase e testimit të disa hipotezave dhe supozimeve fillestare.

Metoda primare e mbledhjes së të dhënave

Gjithsej janë organizuar 4 diskutime në fokus grupe. Diskutimet janë mbajtur me kategoritë vijuese të të anketuarve: anëtarët e familjeve që kanë pas rast të vdekjes në 3 vitet e fundit. Një fokus grup ishte me pjesëmarrësit urban të cilët e kanë regjistruar vdekjen, një me pjesëmarrësit urban të cilët nuk e kanë regjistruar vdekjen, një me pjesëmarrësit rural të cilët e kanë regjistruar vdekjen dhe një me pjesëmarrësit rural të cilët nuk e kanë regjistruar vdekjen e personit në familjen e tyre.

Udhëzuesi për diskutim

Prism Research e ka zhvilluar udhëzuesin për diskutim të fokus grupeve, në konsultim me UNFPA-në.

Procedimi dhe analiza e të dhënave

Diskutimet në fokus grupe ishin mbajtur me moderatorë mire të trajnuar të Prism Research. Diskutimi është mbajtur në objektin e Prism Research në Prishtinë. Ato ishin audio-incizuar me qëllim të përpilimit të transkriptove, mbi të cilat bazohet një pjesë e këtij raporti. Rezultatet nga diskutimet e fokus grupeve janë përfshirë në këtë raport, së bashku me të dhënat kuantitative.